



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME  
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE  
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Nr.8126 prot.

Tiranë, më 15.12.2020

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

Nr.1813 prot.

Tiranë, më 15.12.2020

**AKT  
I  
KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL**

**“Për rritjen e eficencës dhe unifikimin e disa veprimitarive administrative dhe funksionale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara me ligj.”**

- TË VETËDIJSHËM:** Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020<sup>1</sup>, e cila kërkon nga Prokuroria e Përgjithshme rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimtit të Organizuar dhe Korrupsionit.
- ME SYNIM:** Rritjen e eficencës së funksionimit të organit të prokurorisë, nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme (PP) (përfshi prokuroritë me juridiksim të përgjithshëm), me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Krganizuar (PPKKO), dhe

<sup>1</sup> Shih, Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 “Për vlerësimin e veprimitarisë së prokurorisë për vitin 2019” në pikën 1 të cilës është parashikuar:

“...për vitin 2020 Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë:  
1. Rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimtit të Organizuar dhe Korrupsionit për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale.”

unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe funksionale ndërinstitucionale në standarde evropiane, duke siguruar integritetin, pavarësinë dhe kompetencën në funksionimin e secilës palë, pjesë e organit të prokurorisë, si dhe për rritjen e efektivitetit dhe përformancës të sistemit të drejtësisë penale;

**DUKE RIAFIRMUAR:**

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës, Kodeve dhe ligjeve të zbatueshme gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kompetencës lëndore të institucioneve palë, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënieve, transparencës dhe eficencës të sistemit të drejtësisë penale.

**NË MBËSHTETJE TË:**

Neneve 148, 148/b, 148/dh e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

-Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;

-Neneve 74, 75/a e vijues të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;

-Neneve 1 pika 2, 3, 4, 5, 6 14, 15, 16, **38 pika 2 shkronja “ë”**, 57 pika 2, 70 pika 3, 104 pika 1, 105, 106, 107 e vijue të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

-Neneve 4, 8, 9, **15 pika 2 shkronja “c”** e vijues të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institacioneve për luftën kundër korruptionit dhe krimit të organizuar”.

-Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019”.

**ME PALË NËNSHKRUUESE:**

**Prokuroria e Përgjithshme (PP), e përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Z.Olsian ÇELA, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,**

**dhe**

**Prokuroria e Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO), e përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Z.Arben KRAJA, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,**

**të cilat:**

**bien dakord për Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë:**

Neni 1  
**Objekti**

1. Sigurimi i bashkërendimit nëpërmjet masave të nevojshme që angazhohen të marrin Palët sipas kompetencave lëndore në drejtimet e mundshme për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive kushtetuese e ligjore, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënie, transparencës, procesit të rregullt ligjor dhe të eficencës të sistemit të drejtësisë penale.

2. Vendosja e komunikimeve të drejtpërdrejta për shkëmbimin e informacionit dhe për marrjen e masave administrative nga Palët për iniciimin e propozimeve ose dhënie opinioni për ndryshime ligjore dhe/ose nxjerjen e udhëzimeve të përgjithshme për të unifikuar zbatimin e masave administrative sipas ligjit me interesa të përbashkëta si institucionë të organit të prokurorisë.

3. Institucionalizimi i bashkërendimit paraprak nga palët në fazat e procedimit penal për të rritur eficencën e veprimtarisë ndërinstitucionale dhe unifikimin e masave lidhur me:

a) kalimin e akteve dhe/ose tërheqjen e akteve në fazën e hetimeve praraprake, sipas kompetencës lëndore të parashikuar në ligj<sup>2</sup> duke garantuar procesin e rregullt ligjor, të drejtat e subjekteve të procedimit penal dhe shmangur zvarritjen e afateve procedurale;

b) sigurimin e efektivitetit dhe vazhdimësisë së hetimeve proaktive në rastet kur gjatë hetimit dhe/ose ndjekjes penale evidentohen cilësi të posaçme të subjektit të veprës penale dhe/ose rrëthana fakti e ligji që ndryshojnë cilësimin juridik të veprës penale, për rrjedhojë dhe kompetencën lëndore;

c) shkëmbimin e informacioneve dhe akteve procedurale në kuadrin e hetimeve pasurore për të rritur efektivitetin në hetimet e tyre sipas tipologjive për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve produkt të veprave penale ose veprimtarisë kriminale.

ç) përfaqësimin e akuzës në Gjykatën e Lartë, kur ekspertiza apo asistenza profesionale është e nevojshme në funksion të cilësisë së përfaqësimit;

d) funksionimin e strukturave përkatëse të secilës Palë në fushën e marrëdhënieve juridikationale me autoritetet gjyqësore të huaja në kuadrin e përfaqësimit nga prokurori i komanduar shqiptar pranë EUROJUST-it;

dh) shkëmbimin e informacionit për personat e dënuar dhe/ose të paraburgosur në rastet kur plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për vendosjen e tyre në regjimin e posaçëm në zbatim të ligjit<sup>3</sup>.

4. Shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënavë statistikore, si në kuadrin e analizave dhe studimeve të përbashkëta, ashtu dhe në kuadrin e informimeve/raportimeve në përbushje të detyrimeve ndërinstitucionale me institucionet brenda vendit dhe/ose me institucionet ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e integrimit në BE, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së, planit të veprimit të ICRG/FATF-së apo angazhime të tjera në këto fusha.

5. Bashkërendimin e rregullt ndërmjet palëve, në nivel qendorë dhe në nivel rrethi gjyqësor, për realizimin e analizave, vlerësimëve dhe raporteve në kuadër, të zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë<sup>4</sup> dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të

<sup>2</sup> Shih, nenet 28 e 29 në lidhje me nenin 75/a të K.Pr.Penale.

<sup>3</sup> Shih, nenin 16 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

<sup>4</sup> Shih, nenin 104 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 1 e 3 parashikojnë:

Ministrave<sup>5</sup>, me synim përmirësimin e politikave institucionale dhe bashkërendimin ndërinstitucional në përbashkjen e angazhimeve të cilët burojnë nga detyrime të përbashkëta në zbatim të ligjt<sup>6</sup>.

6. Palët bashkëpunojnë dhe shkëmbijnë informacion për realizimin e detyrave respektive, në përputhje me kompetencat ligjore, mbrojtjen e të dhënavë personale dhe ruajtjen e sekretit hetimor për çështje konkrete.

## Neni 2

### **Nivelet zbatuese, detyrat dhe takimet e përbashkëta koordinuese**

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve për zbatimin dhe koordinimin e marrëveshjes janë:

a) Nivel qendor:

i) Prokurori i Përgjithshëm ose prokurori/drejtuesi i strukturës i përkatëse i deleguar/autorizuar prej tij;

-Drejtori i Koordinimit Institucional;

ii) Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme ose prokurori/drejtuesi i struktura përkatëse i deleguar/autorizuar prej tij;

b) Në nivel vendor:

i) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë;

---

*"1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, sipas juridiksionit përkatës, raportojnë në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.*

*3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme parashtronjë gjithashtu përpara Kuvendit të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elemente të tjera thelbësore në veprimtarinë e institacioneve përkatëse. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit."*

<sup>5</sup> Shih, nenin 103 të ligjt nr.97/2016 pikat 1,4 e 5 dhe ligjin nr.8678/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar nenin 6 pikë 32.

-ligji nr.97/2016 në nenin 103, pikat 1, 4, 5 parashikon:

*"1. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.*

*4. Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posacme me Këshillin e Ministrave ndalojen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.*

*5. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij."*

-ligji nr.8678/2001 në nenin 6, pikë 32 parashikon:

*"32. Ministri i Drejtësisë organizon punën për mbledhjen e informacionit, me qëllim përgatitjen dhe propozimin pranë Këshillit të Ministrave, të rekomandimeve për prokurorinë, në kuadër të luftës kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë u bën të njobura rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve. Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posacme informacion mbi zbatimin e tyre. Informacioni i marrë vlerësohet nga Ministri i Drejtësisë dhe bazuar mbi gjetjet, i propozon Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë marrjen e masave organizative, sipas ligjt, me qëllim përbashkjen e rekomandimeve."*

<sup>6</sup> Shih, nenet 103, 104, 105, 106 të ligjt nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", nen 15 pikë 2 shkronja "d" e ligjt nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institacioneve për të luftuar korrupcionin dhe krimin e organizuar" " dhe nen 6 pikë 32 e ligjt nr.8678/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë".

ii) Drejtuesi/prokurori i struktura përkatëse i deleguar/autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

2. Në nivel qendror përfaqësues të palëve koordinojnë për të analizuar e vlerësuar securinë e zbatimit të masave institucionale apo ndërinstitucionale dhe/ose problematikat e evidentuara në zbatimin e tyre, si dhe për të koordinuar zbatimin e masave të përbashkëta apo rekomandimeve në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut në interes të bashkërendimit për hetimin e veprave penale sipas kompetencës lëndore të palëve dhe rritjen e efikasitetit në bashkërendimin në kuadrin ndërinstitucional.

3. Në nivel vendor secili institucion nëpërmjet pikave të kontaktit sipas nenit 1 shkronja “b” e këtij neni bashkërendojnë lidhur me kërkimin dhe vlerësimin e informacioneve, kalimin e akteve dhe/ose kërkimin e akteve (referimeve/kallëzimeve penale) përfshi dhe procedimet në fazën e hetimeve proaktive, shkëmbimin e akteve/provave për asete/pasuri produkt ose të ardhura nga veprimtaria kriminale, si dhe për kryerjen e detyrave të përbashkëta në securinë e hetimeve apo ndjekjes penale në çështje komplekse sipas kompetencës lëndore të parashikuar në ligj.

4. Institucionet/strukturat zbatuese të Palëve informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e funksionarëve të angazhuar sipas detyrave të secilës palë në kuadrin e zbatimit të kësaj marrëveshje, si dhe organizojnë takime të përbashkëta, sipas niveleve nëpërmjet:

i) Titullarët e institucioneve në nivel qendror çdo 3 muaj për të diskutuar securinë e zbatimit të masave të kësaj marrëveshje, me synim vlerësimin e arritjeve dhe nevojave për rritjen e efikasitetit, duke përcaktuar drejtimet dhe masat që duhen marrë për përbushjen e angazhimeve ndërinstitucionale.

ii) Pikat e kontaktit në nivel vendor, sipas nevojave kur kërkohet, informojnë për securinë e zbatimit të masave lidhur me objektivat e kësaj marrëveshje, problematikat e evidentuara, planifikimin e securisë së masave vijuese dhe shkëmbimin e informacionit.

### Neni 3

#### **Kontributi i Prokurorisë së Përgjithshme**

Prokuroria e Përgjithshme angazhohet:

1. Të nxjerr një udhëzim të përgjithshëm “*Për rritjen e efektivitetit dhe unifikimin e veprimtarive administrative dhe funksionale me Prokurorinë e Posaçme, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat ligjore*”, sipas drejtimeve të parashikuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshje.

2. Të vendosë komunikime të drejtëpërdrejta për shkëmbim informacioni lidhur me:

a) dhënie opinioni për ndryshime ligjore në sistemin e drejtësisë penale dhe jo vetëm, për propozimet e ardhura për mendim nga ministritë dhe/ose institucionet përkatëse;

b) të dhënat statistikore, si në kuadrin e analizave dhe studimeve të përbashkëta, ashtu dhe në kuadrin e informimeve/raportimeve në përbushje të detyrimeve ndërinstitucionale me institucionet brenda vendit dhe/ose me institucionet ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e integrimit në BE, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së, planit të veprimit të ICRG/FATF-së apo angazhime të tjera në këto fusha.

c) marrëdhënet juridikSIONALE me autoritetet gjyqësore të huaja për rastet me kompetencë lëndorenë të ndryshuar nga njëra palë tek pala tjetër, në kuadrin e

përfaqësimit të tyre nga prokurori i komanduar shqiptar pranë EUROJUST-it, në funksion të rritjes se efektivitetit;

3. Të bashkërendojë për realizimin nga ana metodike të analizave, vlerësimet e raporteve periodike vjetore në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe në kuadër, të zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, ashtu dhe të marrëdhënieve me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me synim përmirësimin e politikave institucionale dhe bashkërendimin ndërinstitucional, në përmbushjen e angazhimeve të cilët burojnë nga detyrimeve të përbashkëta të palëve në zbatim të ligjit.

4. Të sigurojë bashkërendimin e prokurorive me juridiktion të përgjithshëm me Prokurorinë e Posaçme, për të lehtësuar procesin e marrjes dhe shkëmbimit së informacionit dhe akteve sipas parashikimeve në nenin 1 shkronjat “a”, “b”, “c” e “dh” të kësaj Marrëveshje.

5. Në kuadrin e kësaj marrëveshje angazhohet për bashkëpunimin dhe koordinimin edhe në fusha veprimi të tjera të veprimitarisë ndërinstitucionale me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me prokuroritë e juridikcioninit të përgjithshëm.

#### Neni 4 **Kontributi i Prokurorisë së Posaçme**

Prokuroria e Posaçme angazhohet:

1. Të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm “*Për rritjen e efektivitetit dhe unifikimin e veprimitarive administrative dhe funksionale me Prokurorinë e Përgjithshme duke jo vetëm, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat ligjore*”, sipas drejtimeve të parashikuara në nenin 1 “Objekti” i kësaj Marrëveshje.

2. Të sigurojë bashkërendimin paraprak me prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm, në fazat e procedimit penal për të rritur eficencën e veprimitarisë ndërinstitucionale dhe unifikimin e masave lidhur me:

a) kalimin e akteve dhe/ose tërheqjen e akteve në fazën e hetimeve praraprake, sipas kompetencës lëndore të parashikuar në ligj duke garantuar procesin e rregullt ligjor, të drejtat e subjekteve të procedimit penal dhe shmangur zvarritjen e afateve procedurale;

b) sigurimin e efektivitetit dhe vazhdimesisë së hetimeve proaktive në rastet kur gjatë hetimit dhe/ose ndjekjes penale evidentohet cilësi të posaçme të subjektit të veprës penale dhe/ose rrethana fakti e ligji që ndryshojnë cilësimin juridik të veprës penale, përrjedhojë dhe kompetencën lëndore;

c) shkëmbimin e informacioneve dhe akteve procedurale në kuadrin e hetimeve pasurore për të rritur efektivitetin në hetimet e tyre sipas tipologjive për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve produkt të veprave penale ose veprimitarisë kriminale.

c) kërkimin e të dhënat, indicieve dhe akte/prova për persona të dënuar dhe/ose të paraburgosur, për vepra penale në kompetencë lëndore të juridikcionit të përgjithshëm në rastet kur subjektet plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për vendosjen e tyre në regjimin e posaçëm në zbatim të ligjit<sup>7</sup>;

---

<sup>7</sup> Shih, nenin 16 të ligjit nr.81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”

3. Të vendosë komunikime të drejtëpërdrejta me Prokurorinë e Përgjithshme për shkëmbim informacioni lidhur me:

a) dhënie opinioni për ndryshime ligjore në sistemin e drejtësisë penale dhe jo vetëm, për propozimet e ardhura për mendim nga ministritë dhe/ose institucionet përkatëse;

b) të dhënat statistikore, si në kuadrin e analizave dhe studimeve të përbashkëta, ashtu dhe në kuadrin e informimeve/raportimeve në përm bushje të detyrimeve ndërinstitucionale me institucionet brenda vendit dhe/ose me institucionet ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e integrimit në BE, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së, planit të veprimit të ICRG/FATF-së apo angazhime të tjera në këto fusha.

c) marrëdhënet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja për rastet me kompetencë lëndore të ndryshuar nga njëra palë tek pala tjetër, në kuadrin e përfaqësimit të tyre nga prokurori i komanduar shqiptar pranë EUROJUST-it, në funksion të rritjes se efektivitetit;

4. Të bashkërendojë për realizimin nga ana metodike të analizave, vlerësimeve e raporteve periodike vjetore në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe në kuadër, të zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë<sup>8</sup> dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave<sup>9</sup>, ashtu dhe të marrëdhënieve me Këshillin e Lartë të Prokurorisë<sup>10</sup> dhe

<sup>8</sup> Shih, nenin 104 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 1 e 3 parashikojnë:

“1. *Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, sipas juridiksionit përkatës, raportojnë në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.*

3. *Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme parashtronjë gjithashtu përpara Kuvendit të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elemente të tjera thelbësore në veprimtarinë e institucioneve përkatëse. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.*”

<sup>9</sup> Shih, nenin 103 të ligjit nr.97/2016 pikat 1,4 e 5 dhe ligjin nr.8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar nenin 6 pika 32.

-ligji nr.97/2016 në nenin 103, pikat 1, 4, 5 parashikon:

“1. *Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.*

4. *Në marrëdhëni e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posacme me Këshillin e Ministrave ndalojen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.*

5. *Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.*”

-ligji nr.8678/2001 në nenin 6, pika 32 parashikon:

“32. *Ministri i Drejtësisë organizon punën për mbledhjen e informacionit, me qëllim përgatitjen dhe propozimin pranë Këshillit të Ministrave, të rekomandimeve për prokurorinë, në kuadër të luftës kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë u bën të njobura rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve. Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posacme informacion mbi zbatimin e tyre. Informacioni i marrë vlerësohet nga Ministri i Drejtësisë dhe bazuar mbi gjetjet, i propozon Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë marrjen e masave organizative, sipas ligjit, me qëllim përm bushjen e rekomandimeve.*”

<sup>10</sup> Shih, nenin 105 të ligjit nr.97/2016 pika 2 dhe ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korruptionin dhe krimin e organizuar”, nenin 15 pika 2 shkronja “d”.

-ligji nr.97/2016 në nenin 105, pika 2 parashikon:

“2. *Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse.*”

Inspektorin e Lartë të Drejtësisë<sup>11</sup>, me synim përmirësimin e politikave institucionale dhe bashkërendimin ndërinstitucional, në përbashjen e angazhimeve të cilët burojnë nga detyrimeve të përbashkëta në zbatim të ligjit.

5. Në kuadrin e kësaj marrëveshje angazhohet për bashkëpunimin dhe koordinimin edhe në fusha veprimi të tjera të veprimitarise ndërinstitucionale me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me prokuroritë e juridikcioninit të përgjithshëm.

#### Neni 5

#### **Shkëmbimi i informacionit dhe trajnimet**

1. Palët krahas takimeve të përbashkëta të parashikuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje, komunikojnë dhe lidhen me njëra-tjetren përfundimtarisë ndërinstitucionale me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me prokuroritë e juridikcioninit të përgjithshëm.

2. Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale; ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përfundimtarisë ndërinstitucionale", ligjin ligji nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" i ndryshuar; ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3. Palët në bashkëpunim me misionet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale organizojnë aktivitete të përbashkëta trajnuese të prokurorëve, oficerëve të polisë gjyqësore në prokurori dhe strukturave hetimore në policinë e shtetit, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale.

#### Neni 6

#### **Dispozita të fundit**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi përfundimtarisë.

2. Ndryshime mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.

3. Megjithë sa është parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njofuar paraprakisht, me shkrim, palën tjetër.

4. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitoohen në Prokurorinë e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar dhe dy të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme.

-ligji nr.95/2016 në nenin 15, pikë 2 shkronja "d" parashikon:

"2. Drejtuesi Prokurorisë së Posacme ushtron funksionet dhe kompetencat e mëposhtme:

d) brenda datës 1 mars, i dorëzon Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport vjetor me shkrim mbi veprimitarinë e Prokurorisë së Posacme;"

<sup>11</sup> Shih, nenin 106 të ligjit nr.97/2016, i cili në pikën 1 parashikon:

"I. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë përfundimtarisë ndërinstitucionale me Prokurorinë e Përgjithshme."

Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, më datën 15/12/2020.

**DREJTUESI  
I PROKURORISË SË POSAÇME**

**ARBEN KRAJA**



**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

